



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1 nënparagrafin 63.1.1. pikën b) si dhe lidhur me nenin 62 paragrafin 1 nënparagrafin b) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik të pidentifikuar me email adresën “cocrrashpk@gmail.com” të datës 17.03.2023 kundër njoftimit për kontratë të datës 28.02.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi dhe montimi i kamerave” me nr. të prokurimit 616-23-1430-1-2-1 dhe nr. të brendshëm 616 23 040 121, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e paplotë kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik të pidentifikuar me email adresën “cocrrashpk@gmail.com” të datës 17.03.2023 kundër njoftimit për kontratë të datës 28.02.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi dhe montimi i kamerave” me nr. të prokurimit 616-23-1430-1-2-1 dhe nr. të brendshëm 616 23 040 121.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** parashtruesi i kërkesës për rishqyrtim si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Një operator ekonomik pa të dhëna identifikuese përveç email adresës elektronike “cocrrashpk@gmail.com” (tutje “parashtruesi”) me datë 17.03.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë të datës 28.02.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi dhe montimi i kamerave” me nr. të prokurimit 616-23-1430-1-2-1 dhe nr. të brendshëm 616 23 040 121.

Bazuar në nenin 61.1 paragrafin b) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (tutje “RRPP”), me datë 17.03.2023 zyrtari përgjegjës i prokurimit ka pezulluar aktivitetin e prokurimit deri në marrjen e vendimit lidhur me këtë kërkesë për rishqyrtim.

Sipas nenit 61.3 të RRPP, me datë 21.03.2023 zyrtari përgjegjës i prokurimit ka njoftuar për zgjatjen e afatit për trajtimin e kërkesës për rishqyrtim deri me datë 27.03.2023.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim, zyrtari përgjegjës i prokurimit ka gjetur se kërkesa e parashtruesit nuk përputhet me kërkesat e përmendura në nenin 60.1 dhe nenin 60.2 siç përcaktohet me nenin 62.1 paragrafin c) të RRPP. Kjo për arsye se në kërkesën për rishqyrtim sipas formularit F02 në pjesën e parë me titull "Identifikimi i operatorit ekonomik" nuk është evidentuar asnjë e dhënë përmes së cilës do të mund të identifikohet operatori ekonomik që ka parashtruar këtë kërkesë. Në këtë mënyrë nuk është arritur të identifikohet operatori ekonomik që ka parashtruar këtë kërkesë për rishqyrtim. Autoriteti kontraktues ka hulumtuar mënyrën si është parashtruar kërkesa për rishqyrtim me ç'rast informacionin e vetëm që ka evidentuar nga eprokurimi lidhur me parashtruesin është email adresa elektronike e parashtruesit cocrashpk@gmail.com.

Duke u bazuar në nenin 61.2 lidhur me nenin 60.2 të RRPP, me datë 23.03.2023 autoriteti kontraktues ka dërguar në emailin përkatës të parashtruesit një kërkesë për plotësimin e formularit F02 me të dhënat e nevojshme për shqyrtimin e kërkesës për rishqyrtim. Megjithatë edhe pas më shumë se dy (2) ditëve nga kjo kërkesë e zyrtarit përgjegjës të prokurimit, asnjë përgjigje nuk është pranuar nga parashtruesi.

Përmes nenit 61.2 të RRPP përcaktohet si në vijim "Nëse mungon ndonjë nga elementet e përmendura nën nenin 60.2 të kësaj rregullore, Autoriteti Kontraktues, respektivisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, do të kërkojë nga aplikuesi që të plotësojë kërkesën e tij brenda një periudhe jo më të gjatë se dy (2) ditë nga marrja e kërkesës. Nëse parashtruesi i kërkesës nuk vepron sipas kërkesës së lartpërmendur, kërkesa për rishqyrtim do të refuzohet si e paplotë". Duhet cekur po ashtu se përmes nenit 60.2 të RRPP përcaktohet se "Është përgjegjësi e parashtruesit të kërkesës për rishqyrtim që kërkesa të përgatitet dhe dërgohet në autoritet kontraktues para skadimit të afatit të fundit për parashtrim të kërkesës për rishqyrtim".

Nga sa u tha më sipër është gjetur se kërkesa e parashtruesit duhet refuzuar pa shqyrtim *in meritum* të pretendimeve të parashtruesit në kuptim të nenit 62.1. paragrafit c) lidhur me nenin 61.2. dhe 60.2. të RRPP.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1. nënparagrafin 63.1.1. pikën a) lidhur me nenin 62 paragrafin 62.1. nënparagrafin d) të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 27.03.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Prokurimi Prishtine

From: Prokurimi Prishtine
Sent: 23 March, 2023 13:58
To: 'cocrrashpk@gmail.com'
Cc: Visar Shehu; Shqipe Isufi
Subject: Pershendetje
Attachments: Kërkesë për rishqyrtim - Kërkes per rishqyrtim.Pdf

I nderuar ,

Ne kuptim te nenit 60.2 te Rregullores (A01) nr. 001/2022 per prokurimin publik, kerkojme nga ju te kompletioni formularin F02 lidhur me kerkesen per rishqyrtim te dates 17.03.2023. Kjo pasi qe nga kerkesa nuk eshte e mundur te identifikohet parashtruesi (pjesa 1 - Identifikimi i OE). Vetem permes e-prokurimit eshte arritur te zbulohet se dokumenti ne fjale eshte ngarkuar nga kompania juaj. Ju lutem te plotesohet kerkesa per rishqyrtim ashtu sic kerkohet sipas LLP-se dhe pas plotesimit na ridergoni .

Me respekt Departamenti i Prokurimit